REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 29 qershor 2026
Nr. ref.: AGJ 3145/26

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI263/25

Parashtrues

Rexhë Rexhepi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së kohëzgjatjes së procedurave gjyqësore në kontestin e punës dhe kompensimit

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Nexhmi Rexhepi, kryetar
Safet Hoxha, zëvendëskryetar
Bajram Ljatifi, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Rexhë Rexhepi me vendbanim në Gjakovë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga Korab Bokshi, avokat në Komunën e Gjakovës.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës nuk konteston ndonjë akt konkret të autoriteteve publike, por konteston kohëzgjatjen e procedurave gjyqësore në kontestin e punës dhe kompensimit para gjykatave të rregullta.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së kohëzgjatjes së procedurave gjyqësore në kontestin e punës dhe kompensimit. Në lidhje me këtë të fundit, parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 29 gusht 2025, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën e tij përmes postës elektronike, të cilën Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) e pranoi në të njëjtën ditë.

6. Më 3 shtator 2025, Kryetari i Gjykatës përmes Vendimit [Nr. GJR. KI263/25] caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi – Peci, gjyqtare raportuese, ndërsa përmes Vendimit [Nr. KSH. KI263/25] caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Safet Hoxha (kryesues), Radomir Laban dhe Jeton Bytyqi (anëtarë).

7. Më 17 shtator 2025, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 21 janar 2026, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës dorëzimin e dokumenteve shtesë dhe kërkoi sqarim se për cilën procedurë kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së kohëzgjatjes.

9. Më 27 janar 2026, parashtruesi i kërkesës dorëzoi dokumentet e kërkuara nga Gjykata dhe ofroi sqarimin e kërkuar nga Gjykata.

10. Më 10 qershor 2026, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata njëzëri vendosi: (i) të deklarojë kërkesën të pranueshme; dhe (ii) të konstatojë se ka pasur shkelje të paragrafit 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përkitazi me të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm kohor.

Përmbledhja e fakteve

11. Nga shkresat e lëndës rezulton se parashtruesi i kërkesës kishte qenë i punësuar në pozitën "Roje e Natës në Qendrën Shëndetësore "Isa Grezda", NJP "Shtëpia e Shëndetit" në Gjakovë (në tekstin e mëtejmë: Shtëpia e Shëndetit), nga 3 nëntori 1999, me kontratë pune për kohë të pacaktuar.

12. Më 22 tetor 2001, Shtëpia e Shëndetit përmes Aktvendimit [nr. 301] e ndërpreu marrëdhënien e punës së parashtruesit të kërkesës.

Procedura e zhvilluar para gjykatave të rregullta përkitazi me padinë për kthim në vendin e punës

13. Më 11 dhjetor 2001, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesëpadi në Gjykatën Komunale në Gjakovë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Komunale) kundër Shtëpisë së Shëndetit duke kërkuar (i) anulimin e Aktvendimit [nr. 301] dhe (ii) kthimin në vendin e punës.

14. Më 30 prill 2003, Gjykata Komunale përmes Aktgjykimit [C.nr.540/01] (i) aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, (ii) anuloi Aktvendimin [nr. 301] e 22 tetorit 2001 dhe (iii) detyroi të padituren që parashtruesin e kërkesës ta kthejë në punë, të gjitha këto në afat prej 8 ditësh nga dita e marrjes së këtij Aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit me dhunë. Gjykata Komunale arsyetoi se: *"E paditura asnjëherë më parë nuk i ka tërhequr vërejtjen paditësit ashtu që nuk ka pas mundësi që të paraqes arsyet e tij. Konsideron se e paditura në mënyrë kundërligjore ia ka ndërprerë marrëdhënien e punës."*

15. Më 8 korrik 2003, e paditura paraqiti ankesë në Gjykatën e Qarkut në Pejë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Qarkut) për shkak se *"aktgjykimi i Gjykatës së Shkallës së Parë është i pa bazë dhe në tërësi rezultat i shprehjes së lirë të vullnetit se sa i gjendjes faktike."*

16. Më 9 qershor 2006, Gjykata e Qarkut në Pejë përmes Aktvendimit [Ac.nr.364/03] e hodhi poshtë ankesën e Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar si të pasafatshme.

Procedura e zhvilluar përkitazi me propozimin për përmbarimin e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale

17. Më 4 gusht 2006, parashtruesi i kërkesës paraqiti propozim në Gjykatën Komunale për përmbarim të Aktgjykimit [C.nr.540/01] të Gjykatës Komunale dhe sistemin në vendim e punës dhe listën e të ardhurave.

18. Më 4 gusht 2006, Gjykata Komunale përmes Aktvendimit [E.nr.581/06] lejoi përmbarimin e propozimit të kreditorit bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës Komunale [C.nr.540/01] të 30 prillit 2003, i plotfuqishëm nga 9 qershori 2006.

19. Nga shkresat e lëndës rezulton se, më 22 prill 2008, Gjykata Komunale përmes Aktvendimit [E.nr.586/06] pezulloi procedurën përmbarimore në këtë çështje.

20. Më 27 prill 2010, Gjykata e Qarkut përmes Aktvendimit [Ac.nr.506/08] pranoi ankesën e Shtëpisë së Shëndetit, prishi Aktvendimin [E.nr.581/06] të 22 prillit 2008 të Gjykatës Komunale dhe ktheu lëndën në gjykatën e shkallës së parë për rishqyrtim dhe rivendosje. Gjykata e Qarkut vlerësoi se gjykata e shkallës së parë në procedurë të rivendosjes duhet t'i eliminojë lëshimet sa i përket subjektivitetit të palëve në

procedurë, përkitazi me përcaktimin se kush është suksesor juridik i debitorit në këtë rast.

21. Më 14 dhjetor 2011, Gjykata Komunale përmes Aktvendimit [E. Nr. 495/10] pezulloi procedurën përmbarimore në çështjen e parashtruesit të kërkesës, në cilësinë e kreditorit ndaj debitorit Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare për kthim në punë dhe sistemim në listën e të ardhurave personale. Gjykata Komunale arsyetoi se nga vlerësimi i dosjeve të të punësuarve në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, gjeti se: *"[...] stafi i të punësuarve në QKMF është me kualifikim superior si mjek dhe specialistë të mjekësisë nga lëmia e mjekëve familjarë dhe stomatologëve, i mesëm si staf i infermierëve, ndërsa nga stafi jo medicinal të punësuarit në QKMF del se janë, juristë, ekonomistë, administrator dhe vozitës kualifikimet e të cilëve dallojnë dukshëm nga kualifikimet e nevojshme për të qenë i punësuar si roje nate."* Gjykata, gjithashtu, gjeti se ndryshimet në organizimin e brendshëm të debitorit nuk paraqesin ndërprerje të kontinuitetit të subjektivitetit juridik të debitorit të mëparshëm, Shtëpisë së Shëndetit.

22. Më tutje, Gjykata Komunale vlerësoi se: *"[...] bazuar në urdhëresën administrative nr.2006/14 për zbatimin e Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut 205/55 mbi miratimin e buxhetit të konsoliduar të Kosovës dhe mbi autorizimin e shpenzimeve për periudhën prej 01.01 deri me 31.12.2006, neni 2, dhe dispozitave tjera nga Rregulloret e cituara më lartë, kthimi në punë i kreditorit tek debitori është i pamundshëm për tu realizuar dhe ekzekutimi i tij do të ishte i kundërligjshëm, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi."*

23. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë për shkak të: (i) shkeljes së dispozitave të procedurës përmbarimore; (ii) vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike; dhe (iii) zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

24. Më 2 shtator 2014, Gjykata e Apelit e Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Apelit), përmes Aktvendimit [Ac.nr.3200/12] prishi Aktvendimin [E.nr.495/10] e Gjykatës Komunale dhe lëndën ia ktheu Gjykatës Themelore në Gjakovë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore) në rishqyrtim dhe rivendosje. Gjykata e Apelit konstatoi shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, për shkak se aktvendimi i atakuar nuk përmban arsye vendimtare të vlefshme për marrjen e vendimit. Po ashtu, Gjykata e Apelit theksoi se: *"[...] në arsyetim theksohet se nga data 01.01.2003, janë shuar vendet e punës të rojtarëve për deri sa sipas njoftimit nga Kompania "Panter" konstatohet se nga 01.05.2009, e këndej në QKMF në Gjykovë, kompania në fjalë ka angazhua edhe tre punëtorë tjerë, mirëpo nuk është vërtetua deri në këtë kohë 01.05.2009, kush i ka mbuluar këto vende të punës."*

25. Më 15 nëntor 2016, Gjykata Themelore në Gjakovë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore) përmes Aktvendimit [CP.nr.1250/14] detyroi debitorin, përkatësisht Qendrën e Kryesore të Mjekësisë Familjare, që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh ta kthejë në punë apo ta sistemoj në vendin përkatës të punës kreditorin, respektivisht parashtruesin e kërkesës.

26. Më 21 shkurt 2019, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [CP.nr.1250/14] përfundoi procedurën përmbarimore për kthim në vend të punës, sepse propozuesi – parashtruesi i kërkesës nuk është e mundur që të kthehet në vendin e punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit.

Procedura e zhvilluar para gjykatave të rregullta përkitazi me padinë për kompensimin e të ardhurave personale

27. Më 11 gusht 2006, parashtruesi i kërkesës parashtroi padi në lidhje me kompensimin e të ardhurave personale për periudhën nga 8 tetor 2001 deri më 31 korrik 2006, në vlerë prej 6.932,00 (gjashtë mijë e nëntëqind e tridhjetë e dy) euro.

28. Më 4 shkurt 2008, Gjykata Komunale përmes Aktgjykimit [C.nr.524/06] detyroi të padituren, në emër të kompensimit të ardhurave personale për periudhën 8 tetor 2001 deri më 31 korrik 2007 të ia paguajë parashtruesit të kërkesës shumën prej 7.344,61 € (shtatë mijë e treqind e dyzet e katër euro e gjashtëdhjetë e një cent) me kamatën në lartësi prej 3% dhe t'ia kompensojë shpenzimet procedurale në shumë prej 456.00 (katërqind e pesëdhjetë e gjashtë) euro.

29. Më 12 shkurt 2009, e paditura paraqiti ankesë ndaj Aktgjykimit [C.nr.524/06] për shkak të: (i) shkeljeve qenësore të dispozitave ligjore; (ii) vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike; (iii) aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.

30. Më 21 shtator 2010, Gjykata e Qarkut mori Aktvendim [Ac.nr.208/09] dhe prishi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale [C.nr.524/06] të 4 shkurtit 2008 dhe çështjen ia ktheu të njëjtës gjykatë në rigjykim. Në arsyetimin e Aktvendimit, Gjykata e Qarkut theksoi se: *"Gjykata e shkallës së parë në riprocedurë duhet vlerësuar se a janë të bazuara pretendimet ankimore përkitazi me prapësimin e mungesës së legjitimitetit pasiv të paditurës që i referohet marrëdhënies së punës të cilën e kishte paditësi në Shtëpinë e Shëndetit "Isa Gezda" në Gjakovë me Qendrën Shëndetësore Familjare të themeluar më 1.03.2003 për arsye se kjo e dyta a është subjekt i ri juridik dhe a ka trashëgua detyrimet dhe të drejtat nga Shtëpia e Shëndetit".*

31. Më 6 tetor 2015, parashtruesi i kërkesës, gjatë seancës përgatitore, i propozoi Gjykatës Themelore që të pezullohet procedura në këtë çështje juridiko kontestimore, deri në zgjidhjen e rastit në procedurën përmbarimore [E.Nr.495/2010], e cila lëndë është në procedurë e sipër. Gjykata Themelore në Gjakovë, të njëjtën ditë aprovoi propozimin e parashtruesit të kërkesës përmes Aktvendimit [C.nr.464/10].

32. Më 7 maj 2019, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë në Gjykatën Themelore për vazhdimin e procedurës së ndërprerë [C.nr.464/10].

33. Më 30 shtator 2020, parashtruesi i kërkesës parashtroi në Gjykatën Themelore parashtresë duke kërkuar që e paditura t'ia kompensojë pagat nga data 22 tetor 2001 deri në pensionim, më 12 tetor 2018. Gjithashtu, parashtruesi i kërkesës propozoi caktimin e ekspertizës financiare që të caktohet lartësia e dëmit.

34. Më 25 shkurt 2022, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [C. nr. 689/20] aprovoi padinë e parashtruesit të kërkesës dhe detyroi të padituren Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Gjakovë (ish Shtëpia e Shëndetit) që në emër të kompensimit të të ardhurave personale për periudhën kohore nga 8 tetori 2001 deri më 12 tetor 2018 t'ia paguajë shumën prej 43,777.52 € (dyzet e tremijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë euro e pesëdhjetë e dy cent), në emër të kontributit personal shumën prej 4,739.36 € (katërmijë e shtatëqind e tridhjetë e nëntë euro e tridhjetë e gjashtë cent), si dhe në emër të tatimit në të ardhura personale shumën prej 1,444.53 € (njëmijë e katërqind e dyzet e katër euro e pesëdhjetë e tre cent), respektivisht shumën e përgjithshme prej 49,960.41 € (dyzet e nëntëmijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë euro e dyzet e një cent), me kamatë ligjore prej 8 (tetë) % në vit nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi deri në pagesën definitive.

35. Gjykata Themelore arsyetoi se i padituri, debitori nuk ka përmbushur detyrimin që ka rrjedh nga Aktgjykimi i Gjykatës Komunale [C.nr.540/01], i cili ka arritur formën e prerë më 9 qershor 2006, përkatësisht nuk e ka kthyer në vendin e punës parashtruesin

e kërkesës, e po ashtu nuk ka mundur të ekzekutohet as në procedurë përmbarimore. Andaj, Gjykata Themelore theksoi se: *[...] konform nenit 55 par.1 dhe 80 par.1 pika 1.1 të Ligjit të Punës dhe nenit 245 par.1 dhe 2 të LMD-së, e ka aprovuar kërkesëpadinë dhe e ka detyruar të paditurën që paditësit [parashtruesit të kërkesës] t'i kompensoj pagat në lartësi si në dispozitiv."* Gjithashtu, përkitazi me pretendimin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare lidhur me mungesën e legjitimitetit, Gjykata Themelore vlerësoi se: *"[...] nuk qëndron pasi që nuk ka ofruar asnjë provë se nuk ka legjitimitet, pasi që me Instruksionin administrativ (në shëndetësi) 15/2000, Administrata e Përkohshme, Departamenti i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale i ka Themeluar Qendrat Shëndetësore Familjare, ku bënë pjesë e paditura dhe i ka trashëguar të gjitha të drejtat dhe detyrimet."*

36. Më 5 prill 2022, Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare paraqiti ankesë kundër Aktgjykimit të lartpërmendur për shkak: (i) të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike; dhe (ii) zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

37. Më 12 prill 2022, parashtruesi i kërkesës parashtroi përgjigje në ankesë duke theksuar, ndër të tjera, se *"Gjykata e shkallës së parë, ka vlerësuar drejtë bazën ligjore dhe lartësinë e kërkesëpadisë, pasi që paditësi ka pasur pritje legjitime në detyrimet e të paditurës."*

38. Më 18 korrik 2025, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [AC. nr. 3287/2022] refuzoi ankesën e të paditurës si të pabazuar dhe vërtetoi Aktgjykimin [C. nr. 689/20] të Gjykatës Themelore në Gjakovë. Gjykata e Apelit e vlerësoi se Aktgjykimin e shkallës së parë si të ligjshëm dhe të drejtë dhe se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare. Gjithashtu, Gjykata e Apelit theksoi se: *"Pretendimi ankimor i të paditurës se Qendres Kryesore Mjekesore Familjare në Gjakovë i mungon legjitimiteti real pasiv pasi në momentin e shkëputjes së kontratës institucioni ku ka punuar paditësi ka qenë Shtëpia e Shëndetit dhe jo Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, dhe pretendimi ankimor i të paditurës se ekziston dëshmi se pozita e cila ka qenë duke e ushtruar paditësi (Roje) është shuar në bazë te riorganizimit të bere per mes vendimeve qeveritare, këto pretendime janë të pa bazuara, pasi që kjo çështje është rregulluar me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Gjakovë C.nr.540/01 [...]."*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

39. Parashtruesi i kërkesës pretendon se kohëzgjatja e procedurës pranë gjykatave të rregullta lidhur me rastin në fjalë cenon të drejtën e tij, të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

40. Parashtruesi i kërkesës pretendon se rasti i tij është shembull i një shkeljeje të skajshme të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm.

41. Parashtruesi i kërkesës thekson se *"Procedura gjyqësore është zvarritur për më shumë se 24 vite pa u dhënë epilogu përfundimtar, përkundër faktit se kontestet e punës sipas nenit 475 të Ligjit për Procedurën Kontestimore konsiderohet si konteste të natyrës urgjente. Ky nen obligon gjykatat që të kenë gjithmonë parasysh nevojën e zgjidhjes së ngutshme të këtyre çështjeve."*

42. Më tutje, parashtruesi i kërkesës konsideron se zvarritjet e paarsyeshme kanë sjellë pasoja serioze duke cenuar parimet e drejtësisë dhe të sigurisë juridike, si dhe kanë shkaktuar dëm material dhe jomaterial për parashtruesin.

43. Në kontekst të pretendimit të mësipërm, parashtruesi i kërkesës thekson se çdo vonesë shtesë përkeqëson pozitën juridike dhe ekonomike të tij dhe bie ndesh me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

44. Po ashtu parashtruesi i kërkesës propozon që Gjykata: *"(i) të deklarojë kërkesën të pranueshme; (ii) të konstatojë se ka pasur shkelje të paragrafit 2 të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së; dhe (iii) Republika e Kosovës të kompensojë parashtruesin e kërkesës me shumën prej 10.000,00 euro për dëm jo material, me kamatë dhe shpenzime, në afatin prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij Aktgjykimi."*

Dispozitat përkatëse kushtetuese dhe ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 31
[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

"1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
[...]"

KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Neni 6
(E drejta për një proces të rregullt)

"1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.
[...]"

LIGJI NR. 03/L-006 PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE
Neni 475
(Pa titull)

"Në kontestet nga marrëdhënia e punës, e sidomos me rastin e caktimit të afateve dhe konvokimit të seancave gjyqësore, gjykata gjithmonë do të ketë parasysh nevojën e zgjidhjes së ngutshme të kontesteve nga marrëdhënia e punës."

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

45. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

46. Në këtë drejtim, Gjykata iu referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

> *"(1) Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
> *[...]*
> *(7) Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

47. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu i referohet kritereve të pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata u referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

> *"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*
> *[...]"*

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."*

Neni 49
(Afatet)

> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...".*

48. Përkitazi me përmbushjen e kritereve të lartcekura, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, në kuptim të paragrafit 7 të nenit 113 të Kushtetutës; ai konteston kushtetutshmërinë e një akti të një autoriteti publik, përkatësisht kohëzgjatjen e procedurës gjyqësore në këtë rast, që është zhvilluar në gjykatat e rregullta pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion; i ka specifikuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë, të cilat pretendon se i janë shkelur; dhe sa i përket afatit nëse kërkesa është parashtruar brenda afatit ligjor prej 4 (katër) muajve, siç parasheh neni 49 i Ligjit, Gjykata vlerëson që për shkak të natyrës së kërkesës, respektivisht, kohëzgjatjes së procedurave, kërkesa është parashtruar brenda afatit të paraparë.

49. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës i plotëson kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara përmes paragrafit (1) të rregullit 34 të

Rregullores së punës, dhe nuk mund të shpallet qartazi e pabazuar mbi bazën e paragrafit (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës. Gjykata konstaton se kërkesa është e pranueshme dhe duhet të shqyrtohet në merita.

Meritat

Pretendimi për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës

50. Gjykata vëren se esenca e këtij rasti ndërlidhet me ndërprerjen e marrëdhënies së punës së parashtruesit të kërkesës, i cili kishte qenë i punësuar si rojë nate në Shtëpinë e Shëndetit në Gjakovë që nga viti 1999 me kontratë për kohë të pacaktuar, të cilën kontratë Shtëpia e Shëndetit e ndërpreu më 22 tetor 2001. Parashtruesi i kërkesës, më 11 dhjetor 2001, parashtroi padi për anulimin e Vendimit të punëdhënësit dhe kthim në vendin e punës. Gjykata Komunale, më 30 prill 2003, e aprovoi kërkesëpadinë, anuloi aktvendimin dhe urdhëroi kthimin e parashtruesit të kërkesës në punë, vendim i cili u bë i plotfuqishëm pasi ankesa e të paditurës u hodh poshtë si e pasafatshme. Pas kësaj, parashtruesi inicioi procedurën përmbarimore dhe padi për kompensimin e të ardhurave personale. Më 4 gusht 2006, Gjykata Komunale lejoi përmbarimin e propozimit të parashtruesit të kërkesës, të cilën e pezulloi më 22 prill 2008. Më pas, më 27 prill 2010, Gjykata e Qarkut përmes Aktvendimit pranoi ankesën e Shtëpisë së Shëndetit dhe ktheu lëndën në gjykatën e shkallës së parë për shkak të lëshimeve sa i përket subjektivitetit të palëve në procedurë. Procedura e përmbarimit u pezullua edhe njëherë nga Gjykata Komunale në vitin 2011. Pas ankesës së parashtruesit të kërkesës, Gjykata e Apelit prishi Aktvendimin për pezullim dhe çështjen e ktheu në shkallë të parë. Më 15 nëntor 2016, Gjykata Themelore detyroi Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare që parashtruesin e kërkesës ta sistemoj në vendin e punës. Më pas, më 21 shkurt 2019, Gjykata Themelore përfundoi procedurën e përmbarimore për shkak se parashtruesi e kishte arritur moshën e pensionimit.

51. Ndërkohë, parashtruesi i kërkesës parashtroi padi më 11 gusht 2006 për kompensimin e pagave, të cilën Gjykata Komunale, më 4 gusht 2008, përmes Aktgjykimit vendosi në çështjen për kompensimin e pagave dhe e detyroi të paditurën që parashtruesit të kërkesës t'ia kompensojë të ardhurat personale për periudhën nga 8 tetori 2001 deri më 31 korrik 2007. Duke vepruar sipas ankesës së të paditurës, Gjykata e Qarkut ktheu në rishqyrtim lëndën në gjykatën e shkallës së parë dhe gjeti se kjo e fundit duhet të vlerësojë se kush është suksesor juridik i debitorit, përkatësisht i Shtëpisë së Shëndetit. Më 6 tetor 2015, parashtruesi i kërkesës kërkoi që procedura të pezullohet deri në zgjidhjen e procedurës përmbarimore, ndërsa me 7 maj 2019 kërkoi vazhdimin e saj. Më 25 shkurt 2022, Gjykata Themelore aprovoi padinë e parashtruesit të kërkesës dhe detyroi Qendrën e Mjekësisë Familjare në Gjakovë kompensimin e pagave. Më pas, më 18 korrik 2025, Gjykata e vërtetoi aktgjykimin e shkallës së parë.

52. Parashtruesi i kërkesës pretendon që kohëzgjatja e procedurës gjyqësore për më shumë se 24 (njëzet e katër) vjet, përbën shkelje të parimit të gjykimit "brenda një afati të arsyeshëm", garantuar me paragrafin 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për proces të rregullt) të KEDNJ-së.

53. Andaj, Gjykata në vazhdim do të trajtojë këtë pretendim të parashtruesit të kërkesës në bazë të parimeve të përgjithshme të përcaktuara përmes praktikës së saj gjyqësore, por edhe asaj të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

Parimet e përgjithshme përkitazi me të drejtën për vendim brenda një afati të arsyeshëm

54. Gjykata fillimisht rikujton se paragrafi 2 i nenit 31 të Kushtetutës, përcakton: *"Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme [...]".*

55. Ndërsa, paragrafi 1 i nenit 6 të KEDNJ-së përcakton se "*Çdo person ka të drejtë që [...] të dëgjohet [...] brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë [...], e cila do të vendosë [...] në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij [...] civile [...]".*

56. Bazuar në dispozitat e lartcekura, e drejta për një vendim brenda një afati të arsyeshëm është pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

57. Lidhur me këtë, Gjykata tashmë ka një praktikë relativisht të konsoliduar gjyqësore që përfshinë, por nuk kufizohet në rastet (i) KI64/23, parashtruese *Mejrem Qehaja Rexha,* Aktgjykim i 31 gushtit 2023; (ii) KI06/21, parashtrues *Dragan Mihajlović,* Aktgjykim i 22 dhjetorit 2022; (iii) KI19/21, parashtrues *Sadik Pllana,* Aktgjykim i 18 korrikut 2022; (iv) KI177/19, parashtrues *NNT "Sokoli",* Aktgjykim i 29 marsit 2021; dhe (vi) KI142/23 parashtrues "*Fadil Berisha*", Aktgjykim i 12 shkurtit 2025. Në praktikën e saj gjyqësore, Gjykata ka afirmuar parimet e vendosura nga GJENDJ, përfshirë rastet (i) *Erkner dhe Hofauer kundër Austrisë*, nr. 9616/81, Aktgjykim i 23 prillit 1987; (ii) *Poiss kundër Austrisë*, nr. 9816/82, Aktgjykim i 23 prillit 1987; (iii) *Abdoella kundër Holandës*, nr. 12728/87, Aktgjykim i 25 nëntorit 1992; (iv) *Comingersoll S.A. kundër Portugalisë*, nr. 35382/97, Aktgjykim i 6 prillit 2000; (v) *Mikulić kundër Kroacisë,* nr. 53176/99, Aktgjykim i 7 shkurtit 2002; (vi) *Scordino kundër Italisë* (nr.1), [DhM] nr. 36813, Aktgjykim i 29 marsit 2006; (vii) *Frydlender kundër Francës*, nr. 30979/96, Aktgjykim i 27 qershorit 2000; (viii) *Sürmeli kundër Gjermanisë*, nr. 75529/01, Aktgjykim i 8 qershorit 2006; (ix) *Famullia Katolike Greke Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë*, nr. 76943/11, Aktgjykim i 29 nëntorit 2006; (x) *Mishgjoni kundër Shqipërisë*, nr. 18381/05, Aktgjykim i 7 dhjetorit 2010; dhe (xi) *Nicolae Virgiliu Tănase kundër Rumanisë*, nr. 41720/13, Aktgjykim i 25 qershorit 2019.

58. Bazuar në praktikën e lartcekur gjyqësore, rezulton se (i) përllogaritja e kohëzgjatjes së procedurave gjyqësore fillon nga momenti kur gjykata kompetente vihet në lëvizje me kërkesë të palës për vendosjen e një të drejte apo interesi legjitim të pretenduar; (ii) gjatë llogaritjes merret për bazë procedura në tërësinë e saj, përfshirë këtu edhe procedurat e apelimit dhe procedurën e ekzekutimit të një vendimi gjyqësor përfundimtar; (iii) arsyeshmëria e zgjatjes së një procesi gjyqësor duhet të vlerësohet duke u bazuar në rrethanat përkatëse dhe veçoritë e secilit rast; dhe se (iv) shteti është i detyruar që të organizojë sistemin e drejtësisë në mënyrë të tillë që gjykatat të mund të garantojnë të drejtat e secilit për një vendim përfundimtar gjyqësor, në lidhje me të drejtat dhe obligimet civile të tyre brenda një afati të arsyeshëm kohor (shih, rastet e GJEDNJ-së, *Poiss kundër Austrisë*, cituar më lart, paragrafi 50; *Eckle kundër Republikës Federale të Gjermanisë*, cituar më lart, paragrafi 74; *Comingersoll kundër Portugalisë,* cituar më lart, paragrafi 24; dhe *Lupeni Greek Catholic Parish dhe të tjerët kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 142; dhe rastet e Gjykatës KI06/21, cituar më lart, paragrafët 50-75; dhe KI19/21, cituar më lart, paragrafi 82).

59. Për më tepër, sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës dhe asaj të GJEDNJ-së, arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës gjyqësore matet duke u bazuar në këto kritere kryesore: (i) ndërlikueshmëria e rastit, (ii) sjellja e palës, (iii) sjellja e autoriteteve shtetërore, dhe (iv) rëndësia e asaj se çfarë është në rrezik për palën në

kontestin gjyqësor (shih rastin e GJEDNJ-së, *Surmeli kundër Gjermanisë*, cituar më lart, paragrafi 128; dhe rastin e Gjykatës KI64/23, cituar më lart, paragrafi 65), të cilat në mënyrë të përmbledhur do të elaborohen në vijim.

60. Përkitazi me (i) ndërlikueshmërinë e rastit, kjo mund të ndërlidhet me çështjet faktike dhe ligjore; me përfshirjen e disa palëve në procedurë; me një numër të caktuar provash që duhet trajtuar para gjykatave të rregullta; apo edhe me një numër më të madh të raporteve të ekspertëve që kërkohen. Thënë këtë, edhe në rastet kur një procedurë nuk është komplekse, mungesa e qartësisë dhe parashikueshmërisë në legjislacionin vendor, mund të vështirësojë zgjidhjen e rastit dhe të kontribuojë në kohëzgjatjen e procedurës (shih, në mënyrë të ngjashme rastin e Gjykatës KI64/23, cituar më lart, paragrafët 66-67 dhe rastet e GJEDNJ-së, *Papachelas kundër Greqisë*, nr. 31423/96, Aktgjykim i 25 marsit 1999; dhe *Nicolae Virgiliu Tanase kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 210).

61. Përkitazi me (ii) sjelljen e palës në procedurë, nuk kërkohet nga pala bashkëpunim aktiv me autoritetet gjyqësore, e as nuk mund të fajësohet pala për përdorimin e mjeteve juridike sipas legjislacionit në fuqi, megjithatë, autoritetet shtetërore nuk mund të mbahen përgjegjëse nëse këto veprime ndikojnë në kohëzgjatjen e procedurës; nga pala kërkohet vetëm të jetë e vëmendshme në ndërmarrjen e hapave proceduralë, dhe të mos përdorë taktika për ta shtyrë procedurën në favor të tij; dhe se, vetëm vonesat që i atribuohen Shtetit mund të ndikojnë në përcaktimin nëse procedurat nuk kishin përfunduar brenda një afati të arsyeshëm kohor. Disa shembuj që kanë të bëjnë me sjelljen e palës janë: mungesa e vullnetit për të dorëzuar shkresat, e cila mund të ndikojë në ngadalësimin e procedurës; ndryshimi i shpeshtë i avokatit; përpjekjet për të arritur marrëveshje jashtëgjyqësore; nisja e procedurës përpara gjykatës që nuk ka juridiksion për çështjen; mungesa e kujdesit në ndërmarrjen e hapave proceduralë (shih, rastet e GJEDNJ-së, *Erkner dhe Hofauer kundër Austrisë*, cituar më lart, paragrafi 68; dhe *Union Alemntaria Sanders S.A kundër Spanjës*, nr. 11681/85, Aktgjykim i 7 korrikut 1989, paragrafi 35). Sjellja e palës përbën një fakt objektiv që nuk mund t'i atribuohet autoriteteve shtetërore, dhe duhet të merret parasysh gjatë vlerësimit nëse procedura ishte kryer brenda një periudhe të arsyeshme kohore (shih, rastin e Gjykatës KI64/23, cituar më lart, paragrafi 68-70 dhe KI142/23, cituar më lart, paragrafi 50).

62. Sa i përket (iii) sjelljes së autoriteteve kompetente, shteti mban përgjegjësi për të gjitha autoritetet dhe jo vetëm për sistemin gjyqësor, por edhe sjelljet e institucioneve publike; gjatë vlerësimit nëse procedura është kryer brenda një afati të arsyeshëm kohor; gjykata duhet ta vlerësojë procedurën në tërësi; përkundër që shteti mund të jetë përgjegjës për defekte të caktuara procedurale, megjithatë, kjo nuk e përjashton mundësinë që të ketë vepruar në përputhje me detyrat e veta për ta shqyrtuar rastin në mënyrë të shpejtë; shkaktimi i vonesave nga ndërrimi i shpeshtë i gjyqtarëve nuk e shmang përgjegjësinë e shtetit për kryerjen e procedurave brenda afateve të arsyeshme kohore; mbingarkesa kronike e lëndëve nuk mund të shërbejë si arsyetim për tejzgjatjen e procedurave; dhe se gjykatat nuk mund të lejojnë që rasti të bartet pafundësisht prej një instance gjyqësore te tjetra (shih, rastet e Gjykatës KI64/23, cituar më lart, paragrafi 71-73; dhe KI06/21, cituar më lart, para. 67).

63. Sa i përket (iv) rëndësisë së e asaj se çfarë është në rrezik për palën në kontest, ekzistojnë kategori të caktuara të rasteve, të cilat për nga natyra e tyre duhet të trajtohen me kujdes të veçantë dhe të vendosen me shpejtësi më të madhe. Shembuj të këtyre kategorive të rasteve përfshijnë: rastet që ndërlidhen me statusin; rastet që ndërlidhen me kujdestarinë e fëmijëve; me raportin prind-fëmijë; me kujdesin e gjyshërve ndaj fëmijëve, kur këta të fundit kanë mbetur pa kujdesin e prindërve; përgjegjësinë e prindërve dhe të drejtat e kontaktit me fëmijët; rastet që ndërlidhen me kontestet nga marrëdhënia e punës; ankesa kundër largimit nga puna; suspendimi nga puna;

transferimi; rikthimi në punë; rastet që ndërlidhen me persona të cilët vuajnë nga "*sëmundje të pashërueshme"* dhe kanë *"pritje të reduktuar të jetëgjatësisë*"; rastet që lidhen me pretendimet për ushtrim të dhunës nga zyrtarët policorë; dhe rastet kur mund të rrezikohet e drejta e edukimit. Gjithashtu, Gjykata rikujton se, bazuar në praktikën e GJEDNJ-së, një kategori e caktuar e rasteve kërkon zgjidhje më të shpejtë dhe kujdes të shtuar, përfshirë ndër të tjera kontestet nga marrëdhënia e punës (rasti i Gjykatës, KI67/23, parashtrues *Ejup Koci*, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 korrikut 2024, paragrafi 153; KI210/24, parashtrues *Bashkim Hasi,* Aktgjykim i 5 shkurtit 2025, paragrafi 46; rastet e GJEDNJ-së, *Ruotolo kundër Italisë*, nr. 12460/86, Aktgjykim i 27 shkurtit 1992, paragrafi 17; *Buchholz kundër Gjermanisë,* nr. 7759/77, Aktgjykim i 6 majit 1981, paragrafi 52; *Frydlender kundër Francës*, nr. 30979/96, Aktgjykim i 27 qershorit 2000, paragrafi 45).

Aplikimi i parimeve të lartcekura në rrethanat e rastit konkret

Periudha që do të merret parasysh

64. Gjykata rikujton se më 11 dhjetor 2001, parashtruesi i kërkesës parashtroi padi në Gjykatën Komunale për anulimin e Aktvendimit të punëdhënësit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, si dhe për kthim në vendin e punës. Gjykata Komunale aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës përmes Aktgjykimit të 8 korrikut 2003, i cili u bë i plotfuqishëm nga 9 qershori 2006. Gjithashtu, Gjykata rikujton se më 4 gusht 2006, parashtruesi i kërkesës parashtroi propozim për përmbarimin e Aktgjykimit të lartpërmendur. Në të njëjtën ditë, Gjykata Komunale përmes Aktvendimit [E.nr.581/06] lejoi përmbarimin e propozimit të kreditorit bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës Komunale. Më 27 prill 2010, Gjykata e Qarkut e ktheu lëndën për rishqyrtim në shkallë të parë, për të cilën Gjykata Komunale vendosi më 14 dhjetor 2011 dhe përmes Aktvendimit e pezulloi çështjen përmbarimore. Më 2 shtator 2014, Gjykata e Apelit ktheu në rishqyrtim Aktvendimin në gjykatën e shkallës së parë, të cilën Gjykata Themelore përmes Aktvendimit të 15 nëntorit 2016 e aprovoi propozimin e parashtruesit të kërkesës dhe detyroi Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare që ta sistemoj në vendin përkatës parashtruesin e kërkesës. Më pas, më 21 shkurt 2019, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [CP.nr.1250/14] përfundoi procedurën përmbarimore për kthim në vend të punës, sepse propozuesi – parashtruesi i kërkesës ka arritur moshën e pensionimit dhe nuk është e mundur që të kthehet në vendin e punës.

65. Më tej, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës, gjithashtu kishte parashtruar padi më 11 gusht 2006 për kompensimin e të ardhurave personale, nga viti 2001 deri në vitin 2007, të cilën Gjykata Komunale e aprovoi si të bazuar. Më 21 shtator 2010, Gjykata e Qarkut e prishi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale dhe çështjen e ktheu në rishqyrtim në shkallë të parë. Më 6 tetor 2015, gjatë seancës përgatitore, parashtruesi i kërkesës propozoi që të pezullohet procedura deri në zgjidhjen e procedurës përmbarimore, e për të cilën më 7 maj 2019, parashtruesi i kërkesës kërkoi vazhdimin e procedurës së ndërprerë. Më 25 shkurt 2022, Gjykata Themelore e aprovoi padinë e parashtruesit të kërkesës, të cilën Gjykata e Apelit e vërtetoi më 18 korrik 2025.

66. Prandaj, në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vlerëson se rasti i parashtruesit të kërkesës kishte filluar në vitin 2001, ka vazhduar me Aktgjykim të plotfuqishëm në vitin 2006, pas të cilit kishte filluar procedura për përmbarimin e këtij Aktgjykimi, si dhe ka vazhduar të shqyrtohet edhe pas 15 qershorit 2008, kur Kushtetuta ka hyrë në fuqi. (shih, rastin e Gjykatës: KI142/23, parashtrues *Fadil Berisha*, Aktgjykim i 12 shkurtit 2025, paragrafi 54). Procedura për përmbarimin e Aktgjykimit [C.nr.540/01] të Gjykatës Komunale përfundoi përmes Aktvendimit [CP.nr.1250/14] të Gjykatës Themelore i 21 shkurtit 2019, pas arritjes së moshës së pensionimit të parashtruesit të

kërkesës dhe që për këtë shkak parashtruesi i kërkesës nuk mund të kthehej në vendin e punës. Ndërsa, në procedurën për kompensimin e pagave Gjykata e Apelit, vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore më 18 korrik 2025. Rrjedhimisht, periudha që do të merret parasysh nga Gjykata përfshin periudhën mbi 17 (shtatëmbëdhjetë) vite, përkatësisht për procedurën përmbarimore 10 vite e 8 muaj, ndërsa për procedurën e kompensimit të pagave 17 vite e 1 muaj.

67. Gjykata, për të ardhur në përfundim nëse në rastin e parashtruesit të kërkesës, rasti i tij ishte trajtuar brenda afatit të arsyeshëm, në vijim do të vlerësojë (i) kompleksitetin e rastit, (ii) sjelljen e palës, (iii) sjelljen e autoriteteve shtetërore, si dhe (iv) rëndësinë e asaj se çfarë është në rrezik për palën në kontestin gjyqësor.

(i) Përkitazi me ndërlikueshmërinë e rastit

68. Gjykata vëren se, parashtruesi i kërkesës parashtroi padi për kthim në vendin e punës në Shtëpinë e Shëndetit. Gjykata Komunale, në vitin 2003, aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës dhe detyroi Shtëpinë e Shëndetit kthimin e tij në vendin e punës. Gjykata, gjithashtu vëren se çështja më pas vazhdoi në procedurë të përmbarimit dhe pavarësisht vendimeve për zbatim të Aktgjykimit të Gjykatës Komunale, Shtëpia e Shëndetit, e më pas Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare nuk e sistemoi parashtruesin e kërkesës në një vend të punës, me arsyetimin se pozita përkatëse e punës është shuar. Në fund, procedura e përmbarimit të vendimit gjyqësor përfundoi për shkak të arritjes së moshës së pensionimit të parashtruesit të kërkesës. Gjithashtu, Gjykata vëren se ishte zhvilluar procedura e iniciuar përmes padisë për kompensim të të ardhurave personale, e cila përfundoi me Aktgjykim për aprovimin e të drejtës për kompensimin e të ardhurave personale.

69. Në këtë drejtim, Gjykata vëren çështjet që ndërlidhen me marrëdhënie të punës, përkatësisht kompensimin e pagave, nuk mund të konsiderohen veçanërisht të ndërlikuara. Gjithashtu, Gjykata vlerëson se bazuar në faktet e rastit dhe provat e administruara kontesti nuk ishte i vështirë për t'u zgjidhur.

(ii) Përkitazi me sjelljen e palës

70. Sa i përket sjelljes së parashtruesit të kërkesës, Gjykata vëren se nuk duket që ai të ketë bërë veprime që do ta zgjatnin procesin gjyqësor.

71. Gjykata vëren se, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar kërkesëpadinë në Gjykatën Komunale, nëpërmjet së cilës kërkonte anulimin e Aktvendimit për ndërprerje të punës dhe kthimin në vendin e punës. Ky ishte mjeti i parë juridik të cilin e kishte përdorur parashtruesi i kërkesës, me të cilin e kishte filluar procedurën gjyqësore ndaj të padituri. Më pas parashtruesi i kërkesës parashtroi propozim për përmbarimin e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale, si dhe ndërkohë parashtroi padi për kompensimin e të ardhurave personale.

72. Gjykata vlerëson se, parashtruesi i kërkesës që nga parashtrimi i padisë ishte treguar aktiv dhe i interesuar gjatë gjithë procedurës gjyqësore, dhe nuk mund t'i atribuohen vonesat veprimeve të tij, me përjashtim të periudhës kohore kur kishte kërkuar pezullimin e procedurës së iniciuar me padinë për kompensimin e të ardhurave personale, periudhë të cilën Gjykata nuk do ta llogarisë në vlerësimin e kohëzgjatjes. Andaj, Gjykata konstaton se, parashtruesi i kërkesës nuk kishte kontribuar në vonesat dhe shtyrjet e seancave gjyqësore, si dhe ishte treguar i vëmendshëm me rrjedhën e procedurës.

(iii) Sjellja e autoriteteve kompetente

73. Gjykata, në vlerësimin e sjelljes së autoriteteve kompetente, përkatësisht të gjykatës së shkallës së parë, thekson se procedura për anulimin e Aktvendimit për largimin nga vendi i punës dhe kthimin në vendin e punës, kishte filluar më 11 dhjetor 2001, përmes padisë së parashtruesit të kërkesës, të cilën më 8 korrik 2003, Gjykata Komunale, përmes Aktgjykimit, e aprovoi. Gjykata e Qarkut më 9 qershor e hodhi poshtë ankesën e Shtëpisë së Shëndetit dhe si rezultat aktgjykimi i shkallës së parë e mori formën e prerë.

74. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se, ekzekutimi i një aktgjykimi, konsiderohet pjesë përbërëse e procedurës për qëllimet e llogaritjes kohëzgjatjes së saj. Në këtë kuptim, periudha relevante nuk përfundon me nxjerrjen e vendimit gjyqësor, por vazhdon deri në momentin kur e drejta e kërkuar në procedurë bëhet efektive në praktikë (shih, rastet e GJEDNJ-së, *Martins Moreira kundër Portugalisë*, nr. 11371/85, Aktgjykim i 7 tetor 1988, paragrafi 44; *Silva Pontes kundër Portugalisë* nr. 14940/89, Aktgjykim i 23 marsit 1994, paragrafi 33).

75. Prandaj, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, më 4 gusht 2006 parashtroi propozim për përmbarimin e Aktgjykimit [C.nr.540/01] të Gjykatës Komunale, të cilën Gjykata Komunale e aprovoi në të njëjtën ditë. Ndërsa, nga shkresat e lëndës rezulton se, më 22 prill 2008, sipas kërkesës së kreditorit, Gjykata Komunale përmes Aktvendimit [E.nr.586/06] pezulloi procedurën përmbarimore në këtë çështje. Pas paraqitjes së ankesës të, Gjykata e Qarkut prishi Aktvendimin [E.nr.581/06] të 22 prillit 2008 të Gjykatës Komunale dhe ktheu lëndën në gjykatën e shkallës së parë për rishqyrtim dhe rivendosje, e cila më 14 dhjetor 2011 pezulloi procedurën përmbarimore të parashtruesit të kërkesës. Pas ankesës së parashtruesit të kërkesës, më 2 shtator 2014, Gjykata e Apelit prishi Aktvendimin [E.nr.495/10] e Gjykatës Komunale dhe lëndën ia ktheu Gjykatës Themelore në Gjakovë. Më pas, më 15 nëntor 2016, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [CP.nr.1250/14] detyroi debitorin, përkatësisht Qendrën e Kryesore të Mjekësisë Familjare, që parashtruesin e kërkesës ta kthejë në punë apo ta sistemoj në vendin përkatës të punës. Ndërsa, më 21 shkurt 2019, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [CP.nr.1250/14] përfundoi procedurën përmbarimore për kthim në vend të punës, sepse propozuesi – parashtruesi i kërkesës nuk është e mundur që të kthehet në vendin e punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit.

76. Përkitazi me procedurën e iniciuar sipas padisë për kompensimin e të ardhurave personale, të filluar më 11 gusht 2006, Gjykata vëren se më 4 shkurt 2008 aprovoi padinë e parashtruesit të kërkesës dhe detyroi të paditurën për kompensimin e të ardhurave. Kundër këtij Aktgjykimi, e paditura parashtroi ankesë dhe Gjykata e Apelit më 21 shtator 2010 e prishi Aktgjykimin e shkallës së parë dhe e ktheu në rivendosje. Më tutje, Gjykata vëren se më 6 tetor 2015, parashtruesi i kërkesës në seancë përgatitore, i propozoi Gjykatës Themelore pezullimin e procedurës deri në zgjidhjen e procedurës përmbarimore [E.nr.495/2010]. Ndërsa, më 7 maj 2019, parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata Themelore vazhdimin e procedurës. Gjykata Themelore, më 25 shkurt 2022, përmes Aktgjykimit aprovoi padinë e parashtruesit të kërkesës. Pas ankesës së Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, Gjykata e Apelit më 18 korrik 2025, vërtetoi Aktgjykimin e shkallës së parë.

77. Duke pasur parasysh të lartcekurat, si dhe veprimet procedurale të ndërmarra nga gjykatat e rregullta, Gjykata vlerëson se zgjatja e procedurës në këtë rast nuk mund t'i atribuohet, në thelb, sjelljes së parashtruesit të kërkesës. Përkundrazi, nga rrjedha e procedurës rezulton se kohëzgjatja i atribuohet kryesisht mënyrës së trajtimit të çështjes nga gjykatat e rregullta. Në veçanti, në procedurën përmbarimore, Gjykata vëren se ka periudha të zgjatura në mes të vendimmarrjes së gjykatave, gjykata e

shkallës së parë dy (2) herë përmes aktvendimeve e pezulloi procedurën, si dhe gjykata e shkallës së dytë dy (2) herë përmes aktvendimeve e ktheu çështjen në rishqyrtim. Posaçërisht, Gjykata vëren se më 15 nëntor 2016, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit detyroi Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare që ta sistemojë parashtruesin e kërkesës, si dhe Gjykata vëren se deri në moshën e pensionimit, pas 3 (tre) viteve gjykatat e rregullta nuk kishin ndërmarrë veprime tjera. Andaj, Gjykata konsideron se veprimet dhe mosveprimet e lartcekura kanë ndikuar në zvarritjen e realizimit të së drejtës së parashtruesit të kërkesës.

78. Përkitazi me procedurën për kompensimin e të ardhurave personale, Gjykata vëren se ngjashëm, ka pasur vonesa në vendosje, përjashtimisht periudhës kur parashtruesi i kërkesës ka kërkuar pezullimin e procedurës.

(iv) rëndësinë e asaj se çfarë është në rrezik për palën në kontestin gjyqësor

79. Lidhur me këtë, Gjykata ka sqaruar kategoritë e caktuara të rasteve, të cilat, për nga natyra e tyre duhet të trajtohen me kujdes të veçantë dhe të vendosen me shpejtësi më të madhe. Gjykata rithekson se, bazuar në praktikën e GJEDNJ-së, kontestet nga marrëdhënia e punës hyjnë në kategorinë e rasteve që kërkojnë zgjidhje më të shpejtë dhe kujdes të shtuar.

80. Po ashtu, Gjykata thekson se kontestet e punës kërkojnë vendimmarrje më të shpejtë dhe një gjë e tillë parashikohet edhe nga neni 475 (Pa titull) i Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, që përcakton se gjykata gjithmonë duhet të ketë parasysh nevojën e zgjidhjes së ngutshme të kontesteve nga marrëdhënia e punës.

81. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës ishte larguar nga puna në vitin 2001, në moshën 48 vjeçare, ndërsa në vitin 2003, Gjykata Komunale vendosi se aktvendimi për largimin e tij nga vendi i punës ishte i kundërligjshëm. Pavarësisht asaj se Aktgjykimi i Gjykatës Komunale mori formën e prerë në vitin 2006, Gjykata vëren se vendimi nuk u ekzekutua. Po ashtu, Gjykata rikujton se në vitin 2019, parashtruesi i kërkesës arriti moshën e pensionimit dhe procedura gjyqësore për përmbarimin e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale përfundoi pasi nuk ishte më e mundur që parashtruesi i kërkesës të kthehej në punë. Gjykata thekson se procedura gjyqësore për kompensimin e të ardhurave personale vazhdoi deri në vitin 2025, kur Gjykata e Apelit e vërtetoi aktgjykimin e shkallës së parë, në moshën 71 vjeçare.

82. Gjykata thekson se pavarësisht faktit se Gjykata Komunale kishte vendosur relativisht shpejt dhe në favor të parashtruesit të kërkesës se Aktvendimi për largimin nga vendi i punës kishte qenë i kundërligjshëm, moszbatimi i Aktgjykimit kishte ndikuar negativisht në parashtruesin e kërkesës. Gjykata rikujton se, Gjykata Themelore kishte vërtetuar se parashtruesi i kërkesës nuk kishte lidhur marrëdhënie pune tjetër.

83. Gjykata nuk mund të gjejë ndonjë arsye bindëse që do të mund të legjitimonte tejzgjatjen e procesit gjyqësor në këtë rast, për më tepër kur çështja nuk ishte komplekse për t'u zgjidhur. Gjykatat e rregullta kanë mundur të tregoheshin më të shpejta dhe ta zgjidhnin kontestin kohë më parë. Për Gjykatën nuk është me rëndësi fakti se parashtruesi i kërkesës ka fituar të drejtën në kompensimin e pagave, për arsye se në çdo rrethanë periudha prej mbi 17 (shtatëmbëdhjetë) vite nuk mund të konsiderohet e arsyeshme për zgjidhjen e kontestit nga marrëdhënia e punës.

84. Gjykata konstaton se ka shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, përkitazi me kohëzgjatjen e kontestit gjyqësor nga marrëdhënia e punës.

Përkitazi me kërkesën për kompensim

85. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës ka kërkuar edhe që Republika e Kosovës t'ia kompensojë shumën prej 10,000.00 (dhjetëmijë) euro *"për dëm jo material, me kamatë dhe shpenzime, në afatin prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij Aktgjykimi."*

86. Lidhur me këtë, Gjykata përsërit se nuk ka autorizime ligjore për caktimin e ndonjë lloji të kompensimit për rastet në të cilat konstaton shkelje të Kushtetutës dhe KEDNJ-së si pasojë e tejzgjatjes së procedurave gjyqësore (shih, rastet KI19/21, parashtrues *Sadik Pllana*, cituar më lar, paragrafi 115; KI06/21, cituar më lart, paragrafi 84; dhe KI142/23, cituar më lart, paragrafi 68).

87. Gjykata përsërit se, në disa raste, gjetja e shkeljes kushtetuese paraqet një lloj të "*shpërblimit të drejtë*", sidomos kur parashtruesi ka mundur të pësojë një dëm jo material. Megjithatë, individët mund të kërkojnë dëmshpërblim nga autoritetet publike në rast të konstatimit të shkeljes së të drejtave dhe lirive të tyre kushtetuese. Në rastet kur vetëm konstatimi i shkeljes nuk mjafton dhe kompensimi monetar është i domosdoshëm, individët kanë të drejtë të përdorin mjetet juridike në dispozicion për realizimin e të drejtave të tyre, përfshirë kompensimin e dëmit material dhe jomaterial pranë gjykatave të rregullta (shih, rastet e Gjykatës KI113/21, parashtruese *Bukurije Haxhimurati*, Aktgjykim i 20 dhjetorit 2021, paragrafët 145-151; dhe KI142/23, cituar më lart, paragrafi 69).

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, në nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 48 (1) (a) të Rregullores së punës, në seancën e saj të mbajtur më 10 qershor 2026, njëzëri:

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të paragrafit 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përkitazi me të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm kohor;

III. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve dhe, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës;

IV. TË KONSTATOJË që ky Aktgjykim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtarja raportuese **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Remzije Istrefi-Peci Nexhmi Rexhepi